MBISHKRIME ANTIKE NË GURË E QERAMIKË, NË PREFEKTURËN E BERATIT

Prof. Petrit **BELLIU**

PËRMBLEDHJE

Treva e Beratit, duke përfshirë këtu edhe Tomorin, Skraparin, Shpiragun, Mallakastrën e butë dhe rajonin e Kuçovës, ka qenë në lashtësi një zonë atraktive për banim që nga lashtësia e thellë. Kjo dëshmohet nga gjurmët e shumta të kulturës materiale e shpirtërore të vendbanimeve shpellore parahistorike, vendbanimet rurale dhe ato urbane, si edhe të disa mbishkrimeve në gur e qeramikë, që patëm rastin të konstatojmë gjatë rikonjicionit arkeologjik, bërë prej meje në vitet 70-80, të shekullit paraardhës. I gruambulluam dhe ekspozuam ato në ish-muzeun Arkeologjik të Beratit dhe ish-Kompleksin Muzeal rajonal të Perhondisë, që u ngritën dhe drejtuan, për pak kohë prej meje.

Fjalë Kyçe

Hyrje

1. MBISHKRIME ANTIKE NË GURË E QERAMIKË, NË PREFEKTURËN E BERATIT

1.1 Akaja (*Ἀχαΐα*) & *Kaj, Gaj*

Akaja (*Axaïa*) - është emri gjeografik i pjesës veriore të gatiishullit të Peloponezit. Në kohëra të caktuara, ky emërvend përfaqësonte në harta gjithë Greqinë. Kurse në poemat homerike emri *akej/akejtë (αχάιοι)* përfaqësonte në përgjithësi luftëtarët pellasgë të perëndimit, apo *"grekë"*, (siç gabimisht cilësohen nga autorët post-homerikë, sepse në kohën e Luftës së Trojës, sepse apelativat *"grek"* dhe *"helen"* dhe *"Greqi"* e *"Heladë"* ende nuk njiheshin e nuk përdoreshin). Në Iliadë, krahas apelativave *danaj, argej* e *mirmidonë*, - *Ἀχαιοι ?* (akejtë) përmendet shumë më shpesh (598 herë, përballë 138 herë *danaj*, 29 herë *argej* e më pak *mirmidonë*), që të gjithë pellasgë të perëndimit[1] Sipas meje, *Akajë/Akaja* është shqipja *"**A**[sht]-**kajë** / **A**[sht]-**kaja**"*, ku *'**kajë**'*, do të thotë *shtresë **e gurtë,** masë **e gurtë, gurishte**.* Pra, ***Akajë*** = ***Asht-gur/Asht-e gurtë.*** Edhe sot e kësaj dite ka përdorim,ndonëse rajonal, në shqipe. Psh : *"Gërmimi i pusit ra në **kajë**"*, (thuhet në Perhondi të Beratit); *"Është **kajë** gjithandej", (*dëgjon të thuhet në fshatrat e anës lindore të Shpiragut, por edhe në disa vise të tjera, kryesisht jugore). (vijon…..).

1.2 Treva e Beratit

[1] *Ky mbishkrim, si edhe ai i orës diellore, mjerisht humbën, në rrethana të panjohura për ne, gjatë përpjekjeve për t'ia dërguar për deshifrim e botim të ndjerës Nermin Vlora Falaschi, me kërkesë të saj, pas një vizite, me të shoqin, të ndjerin Renzo Falaschi, në Muzeun Arkeologjik të Beratit.*

Treva e Beratit, duke përfshirë këtu edhe Tomorin, Skraparin, Shpiragun, Mallakastrën e butë dhe rajonin e Kuçovës, ka qenë në lashtësi një zonë atraktive për banim që nga lashtësia e thellë. Kjo dëshmohet nga gjurmët e shumta të kulturës materiale e shpirtërore të vendbanimeve shpellore parahistorike, vendbanimet rurale dhe ato urbane, si edhe të disa mbishkrimeve në gur e qeramikë, që patëm rastin të konstatojmë gjatë rikonjicionit arkeologjik, bërë prej meje në vitet 70-80, të shekullit paraardhës. I gruambulluam dhe ekspozuam ato në ish-muzeun Arkeologjik të Beratit dhe ish-Kompleksin Muzeal rajonal të Perhondisë, që u ngritën dhe drejtuan, për pak kohë prej meje. Në cilësinë e një informacioni operativ, ato, me pak përjashtime, u trajtuan në një artikull timin, bëtuar në gazetën e Beratit "Kushtrimi", (8.2.1984 dhe, si vijim, 11.2.1984). Repertori onomastik i paraqitur është me interes studimor. Si të gjetur pas këtij publikimi, mbetën pa u kumtuar tre mbishkrime të tjerë, dy prej të cilëve me vlera unikale : një orë diellore, e gjetur në fshatin Kuç të Beratit, me një epigram, që paraqiste katër shkronja të versonit më të hershëm të helenishtes së lashtë, nistore të secilës prej katër anëve kryesore të horizontit dhe radianët përkatës, si dhe një epigram, incizuar në një fragment pitosi (qypi të stërmadh qeramike), gjetur rastësisht në Poshnje, pas një shkarje dheu nga lagështia. Fragmenti kishte përmasat 21x8cm dhe paraqiste një mbishkrim jo të plotë, në tre rreshta, me karaktere që nuk mundi t'i deshifronte as arkeologu i mirënjohur, z. Neritan Ceka, sepse ndoshta ishin një version rajonal apo i modifikuar i alfabetit kadmik*. Mbishkrimi tjetër i pakumtuar i takonte një gurvarri të një gruaje, me emrin Ferusa (ΦΕΡΟΥΣΑ)**, mosha e sëcilës nuk dallohej prej dëmtimit. Hasja e një emri të tillë është interesant nga pikëpamja etimologjike dhe historike. Sepse edhe sot e kësaj dite, sidomos në trevën e Tomorit e të Skraparit, por edhe më gjerë, gjendet ende në përdorim emri vetiak *Feruze* (me theksin mbi -*u*-, ose mbi -*e* fundore), si dhe versioni lokal, shqiptuar si *Beruze.* Madje edhe për meshkuj, hasim ende emrin *Ferùz.* Po ky emër, ΦΕΡΟΥΣΑ, u gjet edhe në një fragment gurvarri,. pranë mbeturinave të asaj që quhet Kalaja e Mbolanit, ish qytezë e periudhës protourbane (sh. VIII-VI para e. re), më e vjetra deri tani në trevën e Beratit. Në të, prej dëmtimesh, mungonte rrokja fondore. Kujtoj këtu, për krahasim, emrin *Simferusa/Sumferusa* (*ΣΥΜΦΕΡΟΥΣΑ*), të përmendur në artikullin tim të sipërthënë. Sipas meje, *Φερουσα* (*Ferùsa/Ferusé*) do të thotë "Durime", "Mirkuptuese", bazuar në *φέρω (njëri nga kuptimet e sëcilës është ''përballoj''/ ''duroj''*(peshën apo pasojat e një të keqeje). Kurse *Simferusa /Sumferusa* ="Durim-madhe"/"Shumë - e duruar", "Shumë -mirkuptuese", ku *ΣΥΜ-* duket të jetë shqipja *shum',* si sinonim i *πολι,* edhe kjo gjithëpo e fondit pellasgo-ilir (P. Belliu, punim i cituar, shkronja P). Kjo, natyrisht, si tezë pune.

PËRFUNDIME

1. Ky mbishkrim, si edhe ai i orës diellore, mjerisht humbën, në rrethana të panjohura për ne, gjatë përpjekjeve për t'ia dërguar për deshifrim e botim të ndjerës Nermin Vlora Falaschi, me kërkesë të saj, pas një vizite, me të shoqin, të ndjerin Renzo Falaschi, në Muzeun Arkeologjik të Beratit.
2. Kurse fotografitë përkatëse humbën gjatë grabitjes asgjësuese të Kompleksit Muzeal rajonal të Perhondisë, ku ato gjendeshin.

**Gurvarri në fjalë u gjet në Sirakë të Tomorrit, ku dukeshin edhe gjurmët e një nekropoli antik). Duke gjykuar nga qramika e kontekstit, dukej t'i përkiste sh.IV para e.re.